

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORIN E SHËRBIMIT
PYJOR TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 2009-2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes , janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 485/8, datë 03/08/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, me shkresën nr.485/10, datë 03/08/2012 dërguar ■■■■■ Ministër i Ministrisë së Mjedist, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ■■■■■ Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ju ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative.

1. Seksioni i policisë pyjore të ushtrojë më shumë kontrolle tematike në zona të veçanta, ku paraqiten më shumë probleme, si: në sektorin e Bizës, A.P.K Dajt, Kërrabë, Ekonominë pyjore Pezë dhe të intensifikojë më shumë punën në drejtim të mbrojtjes së pyjeve nga prerjet ilegale, mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet e ndryshme dhe hedhja e mbeturinave, si dhe mbrojtjen e shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve të pakontrolluara dhe të jashtëligjshme.

Menjëherë

2. Të ndiqen procedimet administrative në gjykatë dhe në zyrën e përmbarimit deri në vjeljen e plotë dhe të mos mjaftohen vetëm me njoftimet.

Vazhdimisht.

3. Të bashkëpunohet me pushtetin vendor për ruajtjen, mbrojtjen e pyjeve dhe zbatimin e ligjshmërisë në fushën e pyjeve, pavarësisht nga forma e pronësisë.

Vazhdimisht

4. Të ushtrohen kontrolle më të shpeshta në qendrat e përpunimit, të shitjes së materialeve drusore.

Vazhdimisht

5. Të miratohet një plan bashkëpunimi midis DSHP Tiranë dhe ARM, ku në bashkëpunim me strukturën e saj të ushtroje kontroll në të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fondin pyjor e kullosor, për dokumentacionin ligjor që ato duhet të kenë dhe pajisjen e tyre me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit të tyre, si: karriera ndërtimi (gurore e lavatriçe), antenat e kompanive celulare, lokale, etj.

Menjëherë

6. Të merren masa për të sistemuar e rakorduar 169 Ha mbivendosje, në zërin “Kullotë brenda Pyllit”, gjatë azhurnimit të kadastrës së Fondit Pyjor, në zbatim të pikës 4, 12 të Udhëzimit nr. 4, “Për mbajtjen e kadastrës së fondit Pyjor e Kullosor”.

Menjëherë

7. Të merren masa për të bërë regjistrimin e Fondit Pyjor në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në pronësi të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë.

Menjëherë

8. Të merren masa për të disiplinimin dhe vënien para përgjegjësisë të individëve etj që shfrytëzojnë pa kriter nënproduktet e pyllit, pa lidhur kontrata me DSHP në zbatim të nenit 3, të ligjit nr. 7792, datë 15.6.1993 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”

Vazhdimisht

9. Të merren masa për të studiuar dhe propozuar pranë MMPAU zonat e reja të gjuetisë.

Menjëherë

10. DSHP të formojë komisionin e testimimit e personave që synojnë të ushtrojnë gjuetinë me funksion në bazë Qarku.

Menjëherë

11. Të merren masa për të organizuar testimin e personave që synojnë të ushtrojnë gjuetinë sipas programit të testimimit që hartohet nga MMPAU, përpara pajisjes së subjektit me leje gjuetie,.

Menjëherë

12. Të merren masa për të hapur faqen e internetit të DSHP Tiranë, ku të publikohet regjistri i lejeve të gjuetisë'

Menjëherë

13 Të merren masa për të llogaritur dhe publikuar kapacitetin e prodhimeve të dyta pyjore, si dhe shfrytëzimi të realizohet nga subjekte private të specializuara dhe përzgjedhja e subjekteve të bëhet nëpërmjet tenderëve, të organizuar nga Organet e Shërbimit Pyjor.

Menjëherë

14. Të merren masa për të disiplinuar me flet-hyrje mjetet e Policisë dhe të Gardës së Republikës, si dhe aplikimin e abonimeve mujore ose vjetore për mjetet e lokaleve që ushtrojnë aktivitet në parkun Kombëtar Mali i Dajtit, duke eliminuar regjistrin pa pagesë ,i cili bëhet shkak për abuzim.

Menjëherë

15. Të merren masa për t'u bashkëlidhur kontratave të qirasë hartat treguese të ngastrave.

Menjëherë

16. Të merren masa për të hartuar planin e rievimit të sipërfaqes pyjore, në përdorim të subjektit [REDAKTUAR] dhe subjektit [REDAKTUAR].

Menjëherë

17. Të merren masa për të arkëtuar fitimin e munguar prej **2,036,594 lekë, nga** subjektet: [REDAKTUAR] në vlerë prej 216,634 lekë, [REDAKTUAR] në vlerë prej 1,630,980 lekë dhe [REDAKTUAR] në vlerë prej 188,980 lekë, në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjor dhe kullosor".

Menjëherë

18. Seksioni i Financë- Marketingut të përfshijë në projektbuxhet kërkesat për fonde për investime në Fondin Pyjor Shtetëror për planet e mbarështimit dhe për shpenzime gjyqësore për dërgimin e padive në Gjykatë dhe Përmbarim për vlerën e dëmeve në kundërvajtjet administrative duke bashkërenduar punën me Seksionet përkatëse në periudhën e hartimit të projektbuxhetit.

Vazhdimisht.

19. Të merren masa për hartimin e rregullores së brendshme të re, për organizimin dhe ndarjen e detyrave të seksioneve, të specialistëve në seksione dhe sektorëve e zonave pyjore si dhe paraqitjen për miratim në MMPAU.

Menjëherë

20. Të bëhen inventarizim i pasurisë së Institucionit dhe nga seksioni i financës për vitet në vazhdim duhet të mbahen inventarët fizik dhe kontabël të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara

Menjëherë.

21. Të analizohet dhe të detajohet vlera prej 72,634,382 lekë që rezulton në aktiv në llogarinë debitorë të ndryshëm dhe në pasiv detyrime e cila është e pazbërthyer.

Menjëherë.

22. Për mbajtjen e regjistrimit të kundërvajtjeve administrative të ngarkohet një person i caktuar i cili duhet të bëjë regjistrimet sipas rubrikave të kërkuara, të plotësojë evidencat që raportohen në MMPAU si dhe të bashkëpunojë me juristen për plotësimin e rubrikave dërgimi në Gjykatë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv dhe Përmbartim për ekzekutim dhe me Seksionin e Financë – Marketingut për vjeljen e dëmeve dhe gjobave.

Vazhdimisht

23. Të hartojë planin për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, planin strategjik, të përcaktojë objektivat, si dhe të hartojë plan-veprimet afatshkurtra për implementimin e Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”.

Menjëherë

24. Në kuadrin e zbatueshmërisë të Ligjit nr. 10.296, datë 08.7.2010, të bëhen kualifikime e seminare për zbrëthimin e ligjit ,mënyrën e analizës së Menaxhimit të riskut, për tu njohur më mirë me konceptet e ligjit si dhe komponentët e MFK, për të gjithë menaxheret e shoqërisë më qellim absorbimin dhe zbatimin sa me të mirë të tyre në praktikë.

Vazhdimisht

25. Të bëhen ndryshime në rregulloren e brendshme , ku të implementohen sistemet e kontrollit të brendshëm.

Menjëherë

26. Të përfshijë në projektbuxhet kërkesat për fonde për investime në Fondin Pyjor Shtetëror për planet e mbarështimit dhe për shpenzime gjyqësore për dërgimin e padive në Gjykatë dhe Përmbartim për vlerën e dëmeve në kundërvajtjet administrative duke bashkërenduar punën me Seksionet përkatëse në periudhën e hartimit të projektbuxhetit.

Vazhdimisht

Për MMPAU Masa Organizative

1. MMPAU të organizojë funksionimin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë në bazë Qarku,

Brenda vitit 2012

2. MMPAU të hartojë planet e menaxhimit për Parkun Kombëtar të Malit të Dajtit sipas zonave dhe të marrë masa për funksionimin e Komitetit të Menaxhimit për zonën e mbrojtur.

Menjëherë

3. MMPAU, në bashkëpunim me Inspektoratin Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, të marrë masa dhe të ndjekë rrugët ligjore për kthim në gjendjen e mëparshme të sipërfaqeve të zaptuara e të zëna me ndërtime pa leje si dhe të marrë masa për mbylljen e aktiviteteve shfrytëzim gurore në territorin e Parkut Kombëtar të Malit të Dajtit.

Brenda vitit 2012

4. MMPAU të programojë fonde për hartimin e planeve të mbarështimit dhe për ndjekjen në Gjykatë të padive për vlerën e dëmeve të shkaktuar nga kundërvajtësit pasi aktualisht janë me dhjetëra raste që nuk kalohen në Gjykatë për ekzekutim për mungesë fondesh.

Me miratimin e buxhetit

5. Të merren masa për hartimin e rregullores së brendshme të re, për organizimin dhe ndarjen e detyrave të seksioneve, të specialistëve në seksione dhe sektorëve e zonave pyjore nga DSHP dhe miratimin nga MMPAU.

Menjëherë

6. Të merren masa në bashkëpunim me Qarkun dhe NjQV për të saktësuar kufijtë administrativ të NjQV dhe saktësimin përfundimtar të inventarëve të pyjeve dhe kullotave.

Menjëherë

7. Të merren masa për të hartuar programet e testimit të gjuetarit, përpara çeljes së sezonit të gjuetisë.

Menjëherë

8. Të merren masa për të hartuar plane të mbarështimit, në ekonominë Pyjore e Kullosore, në sipërfaqet Zonë e Mbrojtur e Peizazh i Mbrojtur, në të cilat të parashikohen punime për rehabilitimin e zonave të mbrojtura, duke parashikuar edhe fonde për realizimin e tyre.

Menjëherë

9. Të merren masa për të realizuar dixhitalizimi e hartave të ekonomive Pyjore dhe Kullosore, nga sektori i kadastrës në Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Brenda vitit 2012

10. Të merren masa për të bërë funksional, Komitetin e Menaxhimit, në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit të zonës, ruajtjen e cilësisë së zonës dhe nxitjen e zhvillimit ekologjik të mjediseve përreth saj dhe zbatimin e kërkesave për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të zonës.

Menjëherë

11. Të merren masa për të miratuar rregulloren e paraqitur nga DSHP Tiranë, për administrimin dhe ruajtjen e Zonës së Mbrojtur Mali i Dajtit.

Menjëherë

12. Në zbatim të ligjit të “Zonave të mbrojtura”, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ndërhyjë tek Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës, që të ç’fuqizohen lejet minerale me subjektet e gurorëve në “Zonat e Mbrojtura”.

Menjëherë

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, ti kërkojmë Ministrin të MMPAU z. Fatmir Mediu të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje” për:

1. [REDAKTUAR], me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë.

-Për mos rakordimin e punës me seksionet në programimin e projekt-buxhetit, duke mos kërkuar fonde për investime në Fondin Pyjor Shtetëror, në periudhën e hartimit të projektbuxhetit, si dhe duke mos programuar fonde për tarifata që kërkon Gjykata për çdo rast të denoncuar në lidhje me vlerën e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor.

- Për veprimet dhe mosveprimet e kryera për mosdërgimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën 2010-2011, të 86 praktikave të vlerësimit të dëmeve të shkaktuar në fondin pyjor

me vlerë 129.348.550 lekë, ku mosdërgimi ka shkaktuar mosvjeljen e tyre, ku përfshihen edhe rastet që kundërvajtësit janë ndjekur penalisht për vlerën 48.728.500 lekë.

- Për mos kërkesë llogarie dhe vënie para përgjegjësish të [REDAKTUAR] me detyrë shef i Seksionit Policisë Pyjore i cili nuk ka marrë masa për përgatitjen e akt-padive për dëmet e shkaktuara nga kundërvajtësit në fondin pyjor për t'i dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e titullit ekzekutiv dhe në Zyrën e Përmbartimit për ekzekutim.

-Për mosndjekjen në MMPAU pranë strukturave përkatëse deri tek Ministri të zgjidhjes së problemit të akordimit të fondeve për shpenzime gjyqësore, nëse ka ekzistuar realisht, pasi artikulli 602 shpenzime operative ku përfshihet ky zë shpenzimi për vitin 2010 paraqitet me mosrealizim në vlerën 1.139.000 lekë.

Për vitin 2011 DSHP-ja megjithëse ka patur fonde të mjaftueshme në artikullin 602 shpenzime operative në 6-mujorin e parë të vitit 2011 nuk ka shpenzuar fonde për dërgimin në Gjykatë të praktikave të dëmeve të viteve 2009-2011. Duke parë mosrealizimin e këtij zëri MMPAU ka pakësuar fondet në dy raste në muajt korrik dhe nëntor në vlerën 700.000 lekë, të cilat duhet të ishin përdorur për proceset gjyqësore.

Për mos nxjerrjen e urdhrin të brendshëm për ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurisë publike, duke bërë që mbyllja e bilancit të bëhet e pa pasqyruar rezultatin e inventarit në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të VKM nr. 3, datë 17.05.2006 "Për miratimin e Standardeve Kontabël Kombëtare"

2. [REDAKTUAR] me detyrë shef i Seksionit Policisë Pyjore për mospërgatitjen e akt-padive nga ana e juristeve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për periudhën korrik – tetor 2011 e komanduar me Urdhrin nr.419, datë 24.06.2011 "Për komandim juristi në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë" të Ministrit të MMPAU z. Fatmir Mehdiu dhe paraqitjen e tyre tek [REDAKTUAR], me detyrë shef i Seksionit të Financë- Marketingut i cili duhet ti jepte rrugë veprimi pagesës së tarifave Gjyqësore dhe Përmbartimore për dërgimin e tyre në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. [REDAKTUAR], me detyrë Shef i Seksionit të Financës.

-Për mos analizimin dhe detajimin e vlerës 72,634,382 lekë të paraqitur në llogarinë e debitorëve të ndryshëm pa pasur analizën përkatëse të identifikimit të tyre për çdo debitor.

- Për mos kontabilizimin e vlerësimit të dëmeve për rastet e kundërvajtjeve administrativeve në dëmtimin e fondit pyjor

-Për mos kryerjen e inventarizimit dhe përfshirjen në bilancet të aktiveve të qëndrueshme me vlerën e kontabilitetit.

- Për mosbashkëpunimin me Seksionet përkatëse gjatë hartimit të projektbuxhetit për përfshirjen në projektbuxhet të kërkesave për fonde për investime në Fondin Pyjor Shtetëror për planet e mbarështimit si dhe për shpenzime gjyqësore për dërgimin e padive në Gjykatë dhe Përmbartim për vlerën e dëmeve në kundërvajtjet administrative.

- Ti propozohet Ministrit të MMPAU z. Fatmir Mehdiu që ti jepet masa disiplinore që "Vërejtje" për;

4. [REDAKTUAR] me detyrë ish juriste aktualisht juriste në ARM Tiranë.

Për mos përgatitjen e akt padive në 17 raste për vlerësim dëmi në fondin pyjor me vlerë 18.987,750 lekë për dërgimin e praktikave të vlerësimit të dëmeve për kundërvajtje administrative në Pyje kullota dhe Zonat e mbrojtura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për nxjerrjen e titujve Ekzekutiv dhe Zyrën e Përmbartimit për ekzekutim.

Shënim.

1. Për ish punonjësit e mëposhtëm:

[REDAKTUAR] ish-drejtor i DSHP

[REDAKTUAR] me detyrë shefe Financ-Marketingut

Nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre.

Ngarkohet DSHP që për ish punonjësit e mësipërm të larguar nga puna të njoftojë Departamentin e Administratës Publike për rezultatet e auditimit të KLSH.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Rustem Tare, Neritan Matoshi, Agron Maksuti, Mimoza Lloji dhe Athanas Karaja më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiri, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.